



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi kritike dhe të ashpërsisë së lartë në Grafana

Data: 30/03/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	2
Informacione Teknike	2
Rekomandime	2

Përmbledhje Ekzekutive

Grafana Labs ka publikuar disa përditësime urgjente sigurie që adresojnë dy dobësi të rëndësishme që ndikojnë në versione të shumta të Grafana.

Informacione Teknike

Grafana Labs ka publikuar përditësime urgjente sigurie që adresojnë dy dobësi të rëndësishme që ndikojnë në versione të shumta të Grafana. Këto përfshijnë një dobësi kritike të Ekzekutimit të Kodit në Distançë (RCE) dhe një dobësi të Mohimit të Shërbimit (DoS) me ashpërsi të lartë.

- CVE-2026-27876 (CVSS 9.1 – Kritike): Lejon shkrimin arbitrar të skedarëve që çon në ekzekutimin e kodit në distancë.
- CVE-2026-27880 (CVSS 7.5 – E Lartë): Lejon sulmuesit e paautorizuar të rrëzojnë instancat e Grafana për shkak të shterimit të memories.

Versionet e Prekura

- Grafana v11.6.0 dhe më të reja (CVE-2026-27876)
- Grafana v12.1.0 dhe më të reja (CVE-2026-27880)

Versionet e Përditësuara

- 12.4.2
- 12.3.6
- 12.2.8
- 12.1.10
- 11.6.14

Rekomandime

AKSK rekomandon :

o Përditësoni menjëherë në një nga versionet e përditësuara.